

SIGURIMI KUFITAR I MJETIT MOTORIK

KUSHTET E PËRGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

1. Objekt i kësaj kontrate të lëshuar nga ALBSIG sh.a. është sigurimi i përgjegjësisë të drejtuesit të mjetit motorrik për dëmet që ky drejtues mund t'i shkaktojë palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij me faj, në perputhje me parashikimet e Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" në zbatim të ligjit të mësipërm dhe brenda kufijve të përcaktuar, lidhur me dëmin pasuror dhe dëmin jopasuror, në rast vdekjeje, të dëmtimeve trupore dhe përkeqësimit të shëndetit të shkaktuar palëve të treta. Këtu përfshihen edhe dëmet jo pasurore që pësojnë pasagjerët në mjetet motorrike të destinuara për transportin e tyre. Sendet dhe objektet e përdorimit të zakonshëm, të cilat për vetë natyrën e tyre mbahen me vete nga personat që transportohen, janë objekt i këtij paragrafi. Kjo kontratë sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2. Llogaritja e masës së dëmshpërblimit ndaj paleve të treta, për detyrimin që buron nga kjo policë sigurimi, për dëmin e shkaktuar në një aksident, kryhet vetëm mbi bazën e Ligjit 10 076 nr. 10 076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores nr. 53 datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që

mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" në zbatim të ligjit të mësipërm. **3.** Në të gjitha ato raste kur mjeti motorrik i jepet në përdorim një personi, emri i të cilit nuk është shkruajtur në policën e sigurimit, pronari i mjetit duhet të marrë një leje paraprake me shkrim për dhënie autorizimi nga Shoqëria e Sigurimit që ka lëshuar policën, e cila lejon dhënien e autorizimit për përdorimin e mjetit nga personi tjetër.

DISPOZITA TË TJERA

4. Afati i parashkrimit të palës së tretë të dëmtuar për kërkimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit është 2 vjet nga dita e ndodhjes së aksidentit në bazë të nenit 115 shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë; **5.** Në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 10 076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", pala e dëmtuar i drejtohet me kërkesë për dëmshpërblim shoqërisë të sigurimit. Vetëm pas marrjes së përgjigjes, pala e dëmtuar që ka pretendime mund t'i drejtohet gjykatës me padi civile; **6.** I Siguruari është i detyruar të njoftojë Rastin e Sigurimit menjëherë por jo më vonë se 72 orë nga momenti i ndodhjes së tij ose nga dita në të cilën ka marrë dijeni, pranë shoqërisë së sigurimit. Verifikoni policën tuaj të sigurimit kufitar duke kontaktuar në: konsumatori@amf.gov.al, Tel: +355 4 2257 557, Tel. pa pagesë: 0800 6969, sms: +355 694060671; **7.** "Të dhënat personale të mbledhura nëpërmjet kësaj (emri i policës së sigurimit të detyrueshëm) do të përdoren në administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe

përfituesit, përfshirë trajtimin e dëmit, në zbatim të ligjit Nr.10076 datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Shoqëria e sigurimit (emri i shoqërisë) realizon transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve të ligjit. Në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe përpunimin e tyre, klienti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e aksesit dhe të drejtat e tjera të parashikuara në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale "i ndryshuar".

GENERAL TERMS

INSURANCE OBJECT

1. Object of herein contract issued by ALBSIG sh.a is insurance of motor vehicle drivers' liabilities for damages caused to third parties from vehicle usage, deriving from their faulty actions or inactions, in compliance with law nr. 10 076, dated 12.02.2009 "On Compulsory Insurance in the Transport Sector" and Regulation nr. 53, dated 25.06.2009 "On settlement of claims covered by compulsory insurance contracts in the transport sector", in abidance with the abovementioned law and within the framework of defined limits, regarding material and nonmaterial damages, bodily injury, resulting death or health deterioration caused to third parties. Here are also included nonmaterial damages caused to passengers travelling in motor vehicles, which are destined for their transport. Common use items and objects, which for the sake of their nature are transported under the possession of transported people, are object of the herein paragraph. This insurance contract covers third party liabilities if the insured only for damages

happening in the territory of the Republic of Albania.

GENERAL PROVISIONS

2. The evaluation of third party's indemnification, for obligations arising from this insurance policy, for the damages caused in a road accident, is made solely based on Law Nr.10 076, dated 12.02.2009 "On Compulsory Insurance in the Transport Sector" and Regulation Nr.53, dated 25.06.2009 "On settlement of claims covered by compulsory insurance contracts in the transport sector", abiding the abovementioned law. **3.** In all case the vehicle is given for use to another person, whose name is not included in the insurance policy, the vehicle's owner shall take a preliminary written permission for authorization issued by the respective insurance company, which then allows the authorization for use by another person.

OTHER PROVISIONS

4. Damaged third party's right to ask for indemnification from the insurance company is limited to 2 years from the accident date, in compliance with Article 115, letter ç) of the Civil Code of the Republic of Albania; **5.** In compliance with Article 12 of Law Nr. 10076, dated 12.02.2009, the injured party submits to the liable insurance company a claim for compensation. The damaged party reserves the right to file a claim in court only after receiving an official reply from the insurance company; **6.** The insured is obliged to report to the insurance company the Insurance Case immediately, but not later than 72 hours from the occurrence or from the day of getting notice. To verify your Border Insurance Policy, contact us: konsumatori@amf.gov.al, Tel:+35542257557, Toll free no.: 0800 6969, SMS: +355



ALBSIG

694060671: **7.** The personal Data gathered through this (name of compulsory insurance policy) shall be used to administer the insurance contract, provide services towards the insured and beneficiaries, including but not limited to claim adjustments, in compliance with Law Nr.10076, dated 12.02.2009. "On Compulsory Insurance in the Transport Sector". The insurance company (company name) transfers the personal data to third parties for insurance or/and business purposes according to the specifications foreseen by the law. As regards to the personal data gathering and processing, the client is entitled to have access rights and other rights foreseen by Law Nr.9887, dated 10.03.2008. "Personal Data Protection, Amended".

